



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ Prot.,

Tiranë më _____.____.2025

V E N D I M

Nr. 30, datë 22.12.2025

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 TË AKEP

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z. Gentian Sala	Kryetar
Znj. Edlira Dvorani	Anëtar
Z. Lorenc Bako	Anëtar
Z. Bleron Dokle	Anëtar
Z. Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 22 dhjetor 2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme së Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të AKEP.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 2 e nenit 17, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,
2. Nenet 5 dhe 7, të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”,
3. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar;
4. Udhëzimi nr. 30, datë 23.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit”, i ndryshuar së fundmi me Udhëzimin nr. 16, datë 08.07.2025.
5. Rregullore e Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.7, datë 16.02.2017.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Dokumenti mbi projektvendimin “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të AKEP”.
2. Relacioni mbi projektvendimin “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të AKEP”.
3. Projektvendimi “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të AKEP”.

V Ë R E N:

Në zbatim të parashikimeve ligjore të sipërcituara, buxheti i AKEP për vitin 2026 është i përbërë nga:

1. Totali i të ardhurave vjetore në projektbuxhetin e AKEP nga pagesat që kryhen nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 54/2024, akteve të tjera ligjore në fuqi, si dhe burime të tjera të ligjshme, detajohen sipas zërave si më poshtë:
 - a. Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve në nenin 20 të ligjit nr. 54/2024 dhe Rregullores nr. 22, datë 03.11.2025, “*Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare*”;
 - b. Pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas përcaktimeve në nenin 21, të ligjit nr. 54/2024 dhe VKM nr. 599, datë 23.7.2010, “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktim dhe përdorim të frekuencave, të numrave dhe serive numerike”, i ndryshuar, (VKM nr. 599/2010);
 - c. Pagesat për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike, përfshirë caktimin e emrave të domain-it sipas përcaktimeve në nenin 22 të ligjit nr. 54/2024, dhe VKM nr. 599, datë 23.7.2010, “*Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktim dhe përdorim të frekuencave, të numrave dhe serive numerike*”, i ndryshuar, (VKM nr. 599/2010);
 - d. Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar sipas nenit 27 të ligjit nr. 46/2015 dhe Rregullores nr. 22, datë 03.11.2025, “*Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare*”;
 - e. Pagesat administrative për shërbimet që kryhen nga AKEP në zbatim të regjimit të ri të Autorizimit të Përgjithshëm, sipas masave të përcaktuara me VKD nr. 13, datë 27.08.2025 “Për miratimin e disa pagesave/tarifave administrative për shërbimet që kryhen nga AKEP”;
 - f. Komisionet e përfituara nga veprimtaria si agjent tatimor në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 26, datë 4.9.2008 i Ministrisë së Financave, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 23.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit”, i ndryshuar së fundmi me Udhëzimin nr. 16, datë 08.07.2025.
 - g. Teprica nga të ardhurat nga pagesat rregullatore, që mbetet pa u shpenzuar në përfundim të vitit financiar, gjendje në llogaritë e AKEP-it, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 17 të ligjit nr. 54/2024.
2. Fondi i shpenzimeve të parashikuara për vitin 2026, përmban zërat standarde të shpenzimeve për:
 - Paga për personelin, si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore të lidhura me to;
 - Materiale;
 - Shërbime;
 - Investime.

Parashikimi dhe llogaritja e shpenzimeve sipas zërave të sipërcituar bazohen në:

- Strukturën dhe organikën e AKEP të miratuar me VKD, të AKEP nr. 05, datë 19.05.2025 “Miratimin e strukturës dhe organikës, elementeve përbërëse dhe vlerat e pagës bruto mujore si dhe përshkrimet e punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, i ndryshuar, përcaktimet ligjore mbi detyrimet financiare për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, përcaktimet e udhëzimit nr. 26, datë 4.9.2008, i Ministrisë së Financave, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, mbi punësimin e punonjësve të rinj, për rastet kur është e nevojshme për përballimin e mbledhjes së taksave dhe tarifave kombëtare;
 - Nevojat e institucionit për materiale, shërbime dhe investime në nivel të indeksuar me çmimet mesatare referencë të tregut për mallrat dhe shërbimet sipas zërave, normën e inflacionit, kushtet dhe specifikat e tyre lidhur me amortizimin e pajisjeve, pritshmërinë e realizimit të shpenzimeve për të garantuar veprimtarinë normale të institucionit dhe përmbushjen e rolit dhe funksioneve rregullatore në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare në përputhje me objektivat dhe programin e punës për vitin 2026.
3. Projektbuxheti për vitin 2026, reflekton mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara, sipas burimeve ligjore të financimit për AKEP të parashikuara në akte ligjore dhe nënligjore e më konkretisht, nenin 19 të ligjit nr. 54/2024 dhe nenin 27 të ligjit nr. 46/2015, që realizohet nëpërmjet zërit të pagesave për AKEP të parashikuara për vitin 2026.
 4. Të ardhurat e parashikuara sipas burimeve të financimit, janë llogaritur në të njëjtin nivel me atë të fondit të shpenzimeve administrative në total, në përputhje me statusin ligjor të AKEP si person juridik, publik, jo buxhetor dhe i pavarur, i krijuar me ligj të veçantë.
 5. Dokumenti shpjegues mbi projektvendimin e Këshillit Drejtues për “Miratimin e buxhetit për vitin 2026 të AKEP” jep sqarime të hollësishme ligjore dhe financiare mbi të gjithë zërat e shpenzimeve të parashikuara dhe projektbuxhetin e detajuar për vitin 2026.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë buxhetin e AKEP për vitin 2026, në shumën 516,850,000 lekë (pesëqindëgjatëmbëdhjetë milionë e tetëqindëpesëdhjetë mijë) lekë, të ndarë sipas zërave që paraqiten në Aneksin I, bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për zbatimin e fondit të shpenzimeve administrative për vitin 2026 të AKEP.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka

Aneks 1

BUXHETI I AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2026

Nr.	EMËRTIMI	Në mijë lekë
1	Të Ardhurat	
1.1	Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare	205,500
	a) Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	193,000
	b) Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar	12,500
1.2	Të ardhura nga pagesa për caktimin e përdorimit e frekuencave	114,850
1.3	Pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave, serive numerike, domain	65,075
	a) pagesa për numeracionin	25,900
	b) pagesa për domain	13,655
	c) pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit	25,520
1.4	Të ardhura nga pagesa të tjera	14,125
	a) Nga tarifat administrative për shërbimet e AKEP për regjistrin e AP	14,000
	b) Nga lëshimi i certifikatave	115
	c) Nga interesat bankare	10
1.5	Të ardhura nga komisioni nga agjenti tatimor	55,300
1.6	Teprica buxhetore nga viti i kaluar (gjendja kreditore në bankat e nivelit të dytë dhe arkë)	62,000
	Të ardhura gjithsej:	516,850
2	Shpenzimet	
2.1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera; Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	205,576
2.2	Shpenzime për materiale	5,337
2.3	Shpenzime për shërbime	195,102
2.4	Shpenzime për investime	110,835
	Shpenzime gjithsej:	516,850